



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2021:118646

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05605662

**P.nr.147/21**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa , duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit, Nd.nr.12/24 të datës 16.04.2024 e lidhur në zyrën e ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit R.K nga Kaçaniku dhe përfaqësuesit së të dëmtuarës ... Sh.a Ferizaj, Q.S, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore Ferizaj: PP/II.nr.873/21 të datës 11.06.2021, PP/II.nr.1244/21 të datës 23.08.2021, PP/II.nr.526/22 të datës 14.04.2022 dhe PP/II.nr.130/23 të datës 06.02.2023, për shkak të veprës penale në vazhdim, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, më datën 22.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PRANOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.12/24 të datës 16.04.2024, e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit R.K nga Kaçaniku dhe përfaqësuesit së të dëmtuarës ... Sh.a Ferizaj, Q.S.

**HUDHEN** aktakuzat e Prokurorisë Themelore në Ferizaj: PP/II.nr.873/21 e datës 11.06.2021, PP/II.nr.1244/21 e datës 23.08.2021, PP/II.nr.526/22 e datës 14.04.2022 dhe PP/II.nr.130/23 e datës 06.02.2023, dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit R.K nga Kaçaniku, i

lindur me datë 10.04.1985, për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve në vazhdim nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzat: PP/II.nr.873/21 të datës 11.06.2021, PP/II.nr.1244/21 të datës 23.08.2021, PP/II.nr.526/22 të datës 14.04.2022 dhe PP/II.nr.130/23 të datës 06.02.2023, e ka akuzuar të pandehurin R.K nga Kaçaniku, për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve në vazhdim nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të datës 27.03.2024, pasi që palët në procedurë janë pajtuar që këto aktakuza të bashkohen, janë pajtuar poashtu që lëndët penale të evidentuara si: P.nr.147/21, P.nr.219/21, P.nr.94/22 dhe 2023:035786, të procedohen sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata duke vepruar konform, nenit 8 par.3 të Ligjit për Ndërmjetësim vendosi që çështjet të dërgohen në Zyrën e Ndërmjetësimit.

Me datën 16.04.2024, në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, është arritur marrëveshja ndërmjetësimit, Nd.nr.12/24, në mes palëve në procedurë dhe atë të pandehurit R.K dhe përfaqësuesit të dëmtuarës ... Sh.a Ferizaj, Q.S.

Andaj, Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë Marrëveshje, pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
**DEGA KAÇANIK**  
**P.nr.147/21 datë, 22.04.2024**

Sekretarja Juridike  
Indira Beqa

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**KESHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimet. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.